

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush janë 96 viktimat në Kosovë, për të cilët u dënuan me 81 vite burgim 4 ish-liderët e UÇK-së ?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/kush-jane-96-t-ne-kosove-per-te-cilet-u-denuan-me-81-vite-burgim-4-i586740
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:41:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04ec96f42ab65439de47c14ea669dc18751055709d2a9df07a6da5e7b5fea13f
TEKSTI	7792193c58ad34411a87a0526952b0ec6df854fc3a854d60e11ac78396c7297e
PAMJA	b803d89e2ac4e08888c7696e6c4eab261427e871f2838b4d1eaac6fb009b9b83

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	796eccf3a9250ee543c1773f5b5711f2592ca6ccfd5741f1ee2628dfc33d5945
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/796eccf3a9250ee543c1773f5b5711f2592ca6ccfd5741f1ee2628dfc33d5945>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Kush janë 96 viktimat në Kosovë, për të cilët u dënuan me 81 vite burgim 4 ish-liderët e UÇK-se ?Perse gezohen sot "Kasandrat" e Gjyqates Speciale"Kur u njoha me te, ist fundit

Kush janë 96 viktimat në Kosovë, për të cilët u dënuan me 81 vite burgim 4 ish-liderët e UÇK-së ?

Tema

17 Shtator 2026, 18:39Rajoni TEMA





Nga Musa Kurtulaj

Gjykata Speciale e Kosoves në Hagë ka detyrimin të publikojë emrat e tyre dhe rrethanat e vrasjeve -

-Vëndimi i kësaj gjykate na kujton vëndimin e trupit gjykues për ngjarjet tragjike të 2 prillit të vitit 1991 në Shkoder, ku të 5 të akuzuarit u denuan "për vrasje indirekte !" -

Vendimi i Gjykatës Speciale të Kosovës në Hagë me 16 shtator për 4 ish-liderët e UÇK-së Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin domosdo shtron një pyetje që kërkon përgjigje të qartë publike: kush janë konkretisht 96 personat, për vrasjen e të cilëve Gjykata i shpalli përgjegjës penalisht të akuzuarit?

Sipas njoftimit zyrtar të Gjykatës Speciale, Thaçi u dënua me 25 vite burgim, Veseli me 18, Selimi me 13 dhe Krasniqi me 25 vite – gjithsej 81 vite burgim. Gjykata tha gjithashtu se të katër u gjetën penalisht përgjegjës për ndalim arbitrar të 385 personave, trajtim mizor të 49 personave, torturë ndaj 303 personave dhe vrasje të 96 personave. Pikërisht për këtë arsye, publiku ka të drejtë të kërkojë sa më shumë transparencë dhe qartësi mbi faktet e vendimit. Nëse Gjykata arrin në përfundimin se 96 persona janë vrarë në kuadër të krimeve për të cilat u shpallën përgjegjës të akuzuarit, atëherë pyetjet e drejtëpëdrejta burojnë natyrshëm: cilët janë këta 96 persona me emra ? A janë identifikuar të gjithë?

Cilat janë rrethanat e secilit rast?

Kur dhe ku kanë ndodhur vrasjet?

Çfarë provash ka vlerësuar Gjykata për secilin rast?

Dhe, mbi të gjitha, çfarë motivi dhe qëllimi kriminal ka përcaktuar Gjykata për këto vrasje?

Kjo nuk është thjesht çështje statistikash, prandaj, transparencia gjyqësore nuk duhet të mbetet vetëm te numrat dhe formulimet e përgjithëshme juridike "kanë përgjegjësi se nuk i parandaluan !" Kjo të kujton vëndimin e gjykatës për ngjarjet tragjike të 2 prillit 1991 në Shkoder ku të 5 të akuzuarit u dënua "për vrasje indirekte !"

Tani që u dha vëndimi nuk mund të justifikohet mbajtja sekret për publikun e emërave të viktimave.

Gjykata ka detyrimin e publikimit të listës emërore të tyre dhe për secilën edhe një përmbledhje faktike e asaj që ajo ka konstatuar. Ajo thotë se gjatë këtij procesi janë shqyrtuar dëshmi të 273 dëshmitarëve dhe 5.467 prova materiale. Pra, bëhet fjalë për një proces shumë voluminoz. Pikërisht për këtë arsye, opinioni publik duhet të ketë mundësi të kuptojë se si nga këto prova është arritur te përfundimet përkatëse.

Edhe një element tjetër është i rëndësishëm: Gjykata ka deklaruar se viktimat pjesëmarrëse në këtë proces kanë qenë 156 persona. Kjo tregon se numri i viktimave të përmendura në vendim dhe numri i viktimave pjesëmarrëse në procedurë nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë, ndaj publiku ka nevojë për një shpjegim të qartë mbi kategoritë dhe shifrat. Drejtësia nuk është vetëm vëndimi për dënimin, por është me shumë rëndësi dhe dokumentimi i së vërtetës ku mbështetet që mbështetet vëndimin. Nëse 96 persona janë viktimat të vrasjeve të konstatuara nga Gjykata, atëherë ata nuk duhet të mbeten vetëm një numër në një vendim prej qindra apo mijëra faqesh. Gjykata ka detyrimin të ta shpjegojë qartë këtë dhe të publikojë informacionin faktik për secilin rast. Kosova dhe opinioni publik kanë të drejtë të dinë çfarë ka konstatuar konkretisht Gjykata Speciale. Jo për të paragjykuar viktimat, jo për të relativizuar krimet, jo për të mbrojtur apo dënuar politikisht askënd, por për një arsye themelore: sa më i rëndë të jetë dënimi, aq më e rëndësishme bëhet transparencia mbi faktet që e kanë mbështetur atë. Prandaj pyetja që kërkon përgjigje nga Gjykata mbetet thelbësore:

Kush janë 96 viktimat? Çfarë ndodhi me secilin prej tyre? Çfarë provash u paraqitën dhe çfarë ka konstatuar saktësisht Gjykata për motivin dhe autorësinë e këtyre krimeve? Këtë transparencë, publiku i Kosovës ka të drejtë ta kërkojë nga Gjykata Speciale e Hagës.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

"Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi prekës i gruas së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë

18:33 Rajoni

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ OVL thirrje për protestë mbarëpopullore: Të premten në orën 12:00 në Prishtinë

17:20 Rajoni

“Gjykimi i Hagës u bë në unison me Prokurorinë, vendimet janë pa sens juridik dhe armiqësore”

17:10 Rajoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.